



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË TËRHEQIES NGA KANDIDIMIMI PËR KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË Z.BLEDAR SINELLA, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimimi për kryetar të bashkisë Kavajë, z.Bledar Sinella për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 20, neni 23, pika 1, germa "a" neni 168 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" neni 281 i Kodit të Procedurës Penale, dhe neni 326 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr. 230, datë 24.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 partia "Bindja Demokratike".



Nr. 639 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimimi për kryetar të bashkisë Kavajë z.Bledar Sinella për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Partia, Bindja Demokratike, referuar nenit 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, të kandidatëve për kryetar bashkie si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton Z. Bledar Sinella nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore për z. Bledar Sinella. Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se Z. Bledar Sinella është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me Vendimin me nr. 593 datë 19.05.2019, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, germa "f", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" vendosi:

- Njoftimin e KZAZ-ve përkatëse për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve për kryetarë bashkie të bashkive: Cërrik, Kolonjë, Kurbin, Dibër, Malësi e Madhe, Gramsh, Selenicë, Shijak, **Kavajë** Partia Bindja Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në datë 21.05.2019 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar shkresa me nr.4088 prot., dhe lëndë "Shprehje vullneti për të mos kandiduar dhe njoftim për tërheqje nga kandidimi". Z.Bledar Sinella, referuar kekesës për tërheqje nga kandidimi ndër të tjera pretendon se nuk ka paraqitur asnjë dokument të nënshkruar prej tij pranë KZAZ nr. 42 Kavajë dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 33, germa f, të Kodit Zgjedhor KZAZ me nr. 42, Bashkia Kavajë ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, pasi bashkia Kavajë administrohet nga një KZAZ. Juridiksionin për të shqyrtuar kërkesën e dorëheqies e ka Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe jo KQZ.



Nr. 639 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimi për kryetar të bashkisë Kavajë z.Bledar Sinella për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar kërkesës z. Bledar Sinella ndodhet përballë faktit të informimit mbi mundësinë e një vepre penale, për falsifikim të vulave stampave ose formulareve parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal. KQZ nuk është organi kompetent për të hetuar mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur, konkretisht formulari i vetëdeklarimit të paraqitur në KQZ.

KQZ gjatë shqyrtimit të kërkesës së dorëheqies, në përputhje me pikën 1, të nenit 124 të Kodit Zgjedhor administroi me cilësinë e provës formularin e vetëdeklarimit dhe kërkesën e z.Bledar Sinella me lëndë "Shprehje vullneti për të mos kandiduar dhe njoftim për tërheqje nga kandidimi".

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia referon rastin Prokurorisë së Rrethit Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të Neni 21, pika 20, neni 23, pika 1, germa "a" neni 168 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" neni 281 i Kodit të Procedurës Penale, dhe neni 326 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I

1. Të referoj për kallzim penal, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rastin e z. Bledar Sinella.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 639 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimi për kryetar të bashkisë Kavajë z.Bledar Sinella për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.